



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
Kryesia

Lot. 368

Tiranë, më 02.5.2023

Vendim nr. 19 datë 02.05.2023  
Për krijimin e njësisë studimore të përkohshme  
“Pasuritë ujore”

Referuar nenit 4 pika 6 dhe nenit 19 pikat 1 dhe 3 të Ligjit 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë;

Mbështetur në nenet 44 - 46 të Statutit të Akademisë së Shkencave;

Pasi shqyrtimit të propozimit të Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike (SSHNT, bashkëngjitur) lidhur me kërkesën e një grupi studiuesish për themelimin e një njësie të përkohshme për studimin e pasurive ujore (bashkëngjitur); si dhe të relacionit shoqërues;

Bazuar në mendimin me shkrim të komisionit të përhershëm të biologjisë, bujqësisë dhe veterinarisë (bashkëngjitur);

Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e datës \_\_.5.2023;

Vendosi:

1. Pranë Akademisë së Shkencave të krijohet *njësia studimore e përkohshme “Pasuritë ujore” të Shqipërisë*, me objektiva shkencorë kryesorë: *vlerësimin e gjendjes së tyre në shkallë vendi, në të gjitha format e ekzistencës; kryerjen e studimeve për mbrojtjen dhe shfrytëzimin racional dhe efektiv të tyre; propozimin e rekomandimeve për përmirësimin e mirëqeverisjes në lidhje me këto pasuri.*

2. Relacioni i paraqitur nga nismëtarët si parashtresë në formë projekti për qëllimin, objektivat dhe përparësitë e njësisë (bashkëngjitur) të vlerësohet si dokument bazë për programin e veprimtarinë e njësisë;
3. Njësia e përkohshme kërkimore për studimin e pasurive ujore të njihet me emërtimin e shkurtër *njësia e "Pasurive ujore"*;
4. *Njësia* përbëhet nga bashkëthemeluesit e saj: akad. asoc. Besnik Baraj (Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës) - drejtues; dr. Roza Allabashi (*Institute of Sanitary Engineering and Water Pollution Control, University of Natural Resources and Life Sciences, Wien*) - bashkëdrejtues; prof. asoc. dr. Valbona Kolaneci (*departamenti i akuakulturës dhe peshkimit në Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit - Universiteti Bujqësor i Tiranës*); dr. Bledar Murtaç (*departamenti i kimisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës*); prof. asoc. dr. Lavdim Osmanaj (*Fakulteti i Ndërtimit, Universiteti i Prishtinës*); prof. asoc. dr. Klodjan Skrame (departamenti të gjeologjisë së zbatuar dhe gjeoinformatikës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave (Universiteti Politeknik i Tiranës). Pranë *Njësisë* caktohen dhe dy koordinatorë.
5. Kohëzgjatja e veprimtarisë së saj është deri në 2 vjet.
6. Brenda muajit qershor 2023 *njësia e "Pasurive ujore"* të ketë përfunduar evidentimin e grupeve kërkimore brenda vendit dhe në vendet fqinje, veçanërisht në Kosovë e Maqedoninë e Veriut, që mund të ofrohen për bashkëpunim, duke finalizuar fazën e parë të anëtarësimit e të hartojë rregulloren e saj të brendshme. Deri më 15 korrik *Njësia* zhvillon mbledhjen e saj të parë dhe zgjedh drejtorin ekzekutiv.
7. Akademia e Shkencave siguron mbështetjen logjistike dhe mbulon sipas mundësive të saj shpenzimet financiare për veprimtarinë e njësisë *Pasuritë ujore* në përputhje me statusin e njësive të kërkim-studimit;
8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: kryetari i SSHNT, sekretari shkencor, bordi drejtues i njësisë *"Pasuritë ujore"* dhe kancelari.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akademik Skënder GJINUSHI  
KRYETAR